



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:164156

Datë: 05.01.2021

Numri i dokumentit: 01386974

P.nr.993/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtarit Elmaz Zenuni me sekretaren juridike Igballe Arifi, në çështjen penale kundër të pandehurit O.H. nga Fshati Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.1472/2020 të dt. 23.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur më datën 23.12.2020, në praninë e prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të pandehurit, të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli, ndërkaq, ndërkaq , me datën 05.01.2021, me shkrim përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri, **O.H.** nga Fshati Komuna e Ferizajt , i lindur me dt..... në të njëjtin vend, nga i ati R.dhe e ëma L. e vajzërisë Rr., ka të kryer shkollën fillore, punëtor ndërtimtarie, i martuar baba i 2 (dy) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 04.06.2020 ne shtëpinë e tij në Fshatin Komuna e Ferizajt me qëllim të përvetësimit të shërbimit komunal ka vjedhur energjinë elektrike , në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e punëtorëve të KEDS-it, kanë hasur në keqpërdorim të energjisë elektrike duke lidhur direkt në njësozin elektrik me nr....., i cili ka qenë me bllobë distributive, ku e ka lidhë direkt jashtë pikës matëse në (ne FID) me anë të kabllor, me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in, në shumë prej 134,07 €,-

me këtë kreu veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 3, 4,7, 17, 42, 46, 47, 48, 69, 70, 71,72, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

GJYKON

- DËNIM ME BURG ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-it distrikti në Ferizaj, të i kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 134.07 euro, (me shkronja: njëqind e tridhjetë e katër euro e shtatë cent).
- Obligohet i akuzuari që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP II.nr. 1472/2020 të dt. 23.11.2020, ka ngarkuar të akuzuarin O.H.nga Fshati Komuna e Ferizajt , për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, ku prokurori i shtetit Avdullah Abedini, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri për këtë vepër penale të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze, konform nenit 245 par.2 të KPPRK-së caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 23.12.2020, në të cilën shqyrtim konstatoi se mori pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini, i cili mbeti në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, ku ka propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Konform nenit 246 par.1 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar në pajtim me nenin 246 par 3 të KPPRK-së, përkitazi me pranimin e fajësisë ose deklarimin e tij të pa fajshëm sipas nenit 246 par.4 të KPPRK-së, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit: *i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën me ngarkon akuza, me vjen keq për këtë vepër penale, ndihem thell i penduar, i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë si dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim me vetëdije dhe në shenjë pendimi pranoj veprën penale, jam mbajtës i familjes me 2 fëmijë ,që varen nga puna e tij në ndërtimtari, është hera e parë që ndeshem me ligjin, i kërkoj gjykatës të më shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Përfaqësuesi i KEDS-it Distrikti në Ferizaj nuk ka marrur pjesë në shqyrtimin fillestar, pasi që konform nenit 245 par.7 të KPPRK-së, prania e tij në këtë fazë të procedurës nuk është e domosdoshme.

Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësorë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 383 par. 2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, ashtuqë gjykata vlerësoi se:

- * i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- * pranimi është bërë vullnetarisht;
- * pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësorë dhe atë: Procesverbali me nr. 2512357, i dt. 04.06.2020, Fatura nr.DFEHP....., dt.05.06.2020, dhe foto dokumentacioni , si dhe shkresat tjera te cilat gjinden në lëndë
- * si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje reciproke me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim:

- se më datën 04.06.2020 ne shtëpinë e tij në Fshatin Komuna e Ferizajt me qëllim të përvetësimit të shërbimit komunal ka vjedhur energjinë elektrike , në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e punëtorëve të KEDS-it, kanë hasur në keqpërdorim të energjisë elektrike duke lidhur direkt në njësinë elektrik me nr., i cili ka qenë me bllombë distributive, ku e ka lidhë direkt jashtë pikës matëse në (ne FID) me anë të kabllor , me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in, në shumë prej 134,07 €.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par.1 të KPRK-së, për të pandehurin O. H., të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, edhe atë: veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligje për ruajtjen e

paprekshmërisë se pronës dhe te drejtave pasurore te personave fizik dhe juridik, kjo veprë është kryer me anë të veprimeve aktive dhe të kundërligjshme duke u furnizuar me energji elektrike në mënyrë ilegale, në atë mënyrë që konsumatori ka lidhur direkt jashtë pikës matëse të energjisë elektrike, veprimet këto të kryera me dashje direkte dhe me qëllim të posaçëm për të nxjerr përfitime materiale, pasi që i pandehuri jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij, por edhe ka dëshiruar edhe ardhjen e tyre, çka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prova, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 71, dhe 72 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata të akuzuarit si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, si dhe rrethanë lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte, ka bashkëshorten me 2 fëmijë, të cilët varen nga puna e tij në ndërtimtari dhe nuk ka të ardhura tjera, ka shprehur gatishmëri që borxhin ndaj KEDS-it ta paguaj në tërësi, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave konform nenit 48 par.1 të KPRK-së, i shqiptoj dënimin me kusht si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së, Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-it distrikti në Ferizaj, të i kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 134.07 euro.

Obligohet i akuzuari që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.993/20 i dt. 23.12.2020

Sekretarja juridike

Igballe Arifi

Gjyqtari

Elmaz Zenuni

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,

në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit,

Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet Gjykatës Themelore Ferizaj.